

Zhvillohet Masterklasi V i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive WGMA

Më datë 18.12.2024 u zhvillua Masterklasi i radhës i organizuar nga EUROSAT/WGMA me temë “Kampionimi në përcaktimin e qëllimit të auditimit”.

“

Shtetet anëtare të këtij grupi pune sollën eksperiencat e tyre në lidhje me tematikën e sipërmëndur, si dhe zbatimin në praktikë në auditimet financiare dhe ato të përputhshmërisë. Më konkretisht u përcollën tre materiale prezantuese nga SAT-t si vijon.

Në prezantimin e sjellë nga SAT i Bullgarisë, fokusi qëndroi tek metodat për përcaktimin e fushave kryesore ku do të përqëndroheshin auditimet financiare apo të përputhshmërisë në subjektet e përzgjedhura për auditim. Materiali trajtoi kriteret më të përdorura në përzgjedhjen e elementeve nga pasqyrat financiare komunale, të cilat do të auditoheshin, dhe duke përcaktuar mbi këtë bazë proceset që mund të përfshihen në fushën e auditimit. Gjatë prezantimit u shpjegua me detaje edhe procesi i analizës së riskut me anë të të cilit përcaktoheshin subjektet për t’u audituar. Përpos sa më lart u dhanë shembuj nga auditimet e përputhshmërisë në njësitë vendore dhe mënyra se si janë trajtuar tre fusha kryesore të auditimit, si: Auditimi i procedurave të prokurimit publik, buxheti dhe menaxhimi i aseteve.

SAT i Lituanisë solli eksperiencën e tij në kryerjen e një auditimi të performancës në sistemin arsimor në lidhje me pagat e mësuesve dhe personelit pedagogjik. Materiali trajtoi mënyrën se si fondet buxhetore të dedikuara për arsimin përdoren dhe zbatohen në përputhje me përcaktimet e qeverisë dhe nëse përdorimi racional i ndarjeve të tjera buxhetore zbatohet në mënyrën e duhur.

Fokusi i prezantimit të SAT-t të Izraelit, ishte tek puna e Drejtorisë së Auditimit të Pushtetit Vendor duke dhënë informacion mbi një qasje të re auditimi; jo më të auditimit të kryer vetëm në një institucion, por të auditimeve paralele për të njëjtën tematikë në institucione të ndryshme. Për të lehtësuar auditimin në këtë kahje të re, ky institucion ka ndërtuar një metodologji të strukturuar në tre nivele: Niveli i parë analizon të dhënat e disponueshme për të gjitha institucionet vendore; niveli i dytë fokusohet në një grup më të vogël, duke shqyrtuar të dhëna jo publike ose më pak të aksesueshme; dhe niveli i tretë përfshin analiza të thella të të dhënave të detajuara, jo publike. Sipas materialit të vënë në dispozicion, kjo metodologji e përzgjedhjes parashikon ngarkesën për auditimet e vazhdueshme dhe lehtëson shpërndarjen e ngarkesës së punës së auditimit në mënyrë të barabartë mes grupeve të auditimit. Prezantimi u fokusua gjerësisht në metodologjinë dhe kriteret për përzgjedhjen e subjekteve.

KLSH është një anëtare aktive e këtij grupi pune dhe ky masterklas u ndoq nga audituesit Salvi Deda dhe Marli Muça pranë Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.